
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Tiranë, më 18.09.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim dhe instalim konvertues tensioni alternativ 3- fazë 440-480 V, 60 Hz, 550 - 600 KVA, në kontenier” për nevoja të Komandës së Forcës Detare.

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

Konvertues fuqie 31121110-4

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS:

Fondi limit: **27,837,563 (njëzet e shtatë milion e tetëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa tvsh** ose 303,737.73 (treqind e tre mijë e shtatëqind e tridhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e tre) EURO pa tvsh.

*Vlera e mësipërme është konvertuar në monedhën Euro sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë, datë 17.09.2026, me kurs këmbimi 91.65 (nëntëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e pesë) lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti/Enti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, ndërsa nga ana e grupit të punës të ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare janë hartuar specifikimet teknike me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbeshtetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit objekt prokurimi**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është e mbështetur në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 42 pika 3, nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera

e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” duke qënë se vlera e fondit limit të lotit përkatës është mbi vlerën e kufirit të lartë monetar dhe kriteri për secilin lot dhe konkretisht ai i përmbushjes së xhiros hartohet në përputhje me vlerën e vetë lotit dhe jo vlerës totale të procedurës. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Prokurimit është konsideruar e arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe të sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Marrë shkas nga fakti që referuar përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” te ndryshuar se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar” AK nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së përlllogaritur të vlerës së lotit në kërkesën për kualifikim por në respektim të parimeve ligjore dhe në përmbushjen e qëllimeve të ligjit të prokurimit si më sipër cituar ka tagrin të kërkojë një vlerë më të ulët se dyfishi i vlerës së përlllogaritur të lotit për përmbushjen e vlerës së xhiros minimale vjetore.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumnin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 40 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 39 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik për realizimin e objektit të prokurimit duhet të ketë të punësuar stafin e tij teknik si më poshtë:

- Të paktën **1 (një) Inxhinier elektrik**

-Të paktën **1 (një) person të trajnuar ose çertifikuar për instalimin, konfigurimin testimin dhe vënien në punë të konvertuesit.**

Operatori ekonomik në lidhje me stafin teknik të kërkuar më sipër duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

Për inxhinierin elektrik

- Kontratë pune të vlefshme;

- Diplomë
- Listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Për 1 (një) person të trajnuar ose certifikuar për instalimin, konfigurimin testimin dhe vënien në punë të konvertuesit sipas teknologjisë specifike të prodhuesit.

- Kontratë pune të vlefshme ose kontratë bashkëpunimi;
- Çertifikatë/Dëshmi trajnimi/Dëshmi kualifikimi lëshuar nga prodhuesi i pajisjes/distributorë/përfaqësues të autorizuar nga prodhuesi ose certifikime ekuivalente, me qëllim kryerjen e instalimit, konfigurimit testimit dhe vënies në punë të konvertuesit.

***Shënim:** I njëjti person mund të përmbushë njëkohësisht të dyja kërkesat e mësipërme nëse është njëkohësisht inxhinier elektrik dhe disponon dëshminë e trajnimit/kualifikimit të kërkuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar.

Shënim: Kriteri Nr.2.3.2 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit shtojca 9. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; Vendimi 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP) të rishikuar” dhe Urdhërit nr.99, datë 25.05.2021 “Për miratimin e katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Punonjësit e sipërpërmendur kërkohen në përputhje të plotë me objektin e prokurimit. Duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin teknik të objektit të prokurimit, i cili konsiston në furnizimin me një konvertues tensioni alternativ 3-fazor me kapacitet 550–600 kVA, me konvertim të parametrave elektrikë nga 380 V/50 Hz në 440–480 V/60 Hz, si dhe kërkesën për instalimin, konfigurimin, testimin dhe vënien në punë të pajisjes, vlerësohet e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë personel me kompetencat teknike përkatëse.

Kërkesa për 1 (një) inxhinier elektrik/elektroenergjetik justifikohet nga natyra elektrike dhe fuqia e lartë e pajisjes, si dhe nga nevoja për njohuri profesionale në lidhje me lidhjet elektrike, parametrat e furnizimit, mbrojtjet, konfigurimin dhe verifikimin e funksionimit të sistemit. Inxhinieri elektrik do të shërbejë si personi me përgjegjësi profesionale për mbikëqyrjen dhe koordinimin e veprimeve teknike gjatë instalimit, konfigurimit dhe testimit të pajisjes.

Ndërkohë, kërkesa për 1 (një) person të trajnuar/kualifikuar nga prodhuesi i pajisjes ose nga distributori i autorizuar prej tij lidhet me karakterin specifik të teknologjisë së konvertuesit. Trajnimi nga prodhuesi siguron që personi përgjegjës për instalimin, konfigurimin, testimin dhe vënien në punë të ketë njohuri specifike mbi teknologjinë, parametrat e konfigurimit, mënyrën e funksionimit dhe procedurat e rekomanduara nga prodhuesi për pajisjen konkrete.

Për rrjedhojë, këto dy kërkesa synojnë të sigurojnë që kontrata të realizohet në mënyrë të sigurt dhe sipas kërkesave teknike të pajisjes, duke kombinuar kompetencën profesionale në fushën e inxhinierisë elektrike me njohjen specifike të teknologjisë së prodhuesit.

Kërkesa konsiderohet proporcionale me objektin e kontratës, pasi kufizohet në një inxhinier elektrik dhe një person të trajnuar për teknologjinë konkrete, pa kërkuar kategori të tjera personeli që nuk lidhen drejtpërdrejt me realizimin e objektit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, i njëjti person mund të përmbushë të dyja kërkesat, nëse plotëson njëkohësisht kriterin e kualifikimit si inxhinier elektrik/elektroenergjetik dhe disponon dëshminë e trajnimit/kualifikimit të kërkuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë dhe ti provojnë Autoritetit Kontraktor se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën me sukses.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të dorëzojë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për artikujt objekt prokurimi. Operatori ekonomik ofertues në rast paraqitje autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, website) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: *Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.*

Kriteri është hartuar në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkimi i autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për këtë pajisje është një masë e mirë për të mbrojtur interesat e institucionit j dhe për të siguruar një prokurim të drejtë dhe transparent.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **katalogë / broshurë / skedë teknike** të prodhuesit për artikullin objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. *Operatori ekonomik*

duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike”, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve/skedës teknike/broshurë nga prodhuesi është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit kontraktor si Organ Qendror Blerës verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa për katalogun /skedën teknike/broshurën ka disa avantazhe pasi siguron besueshmëri të informacionit. Një dokument teknik garanton që informacioni të jetë i saktë dhe i përditësuar. Përputhshmëria me specifikimet teknike siguron që produktet e ofruara përputhen me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e prokurimit. Në kete formë reduktohet rreziku i mashtrimeve ose i ofrimit të produkteve të falsifikuara.

Për sa më sipër, përmes përmbushjes së kësaj kërkesë, AK krijon siguri dhe garanci se mallrat me të cilët do të furnizohet janë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST. Ky katalog do të shërbejë gjithashtu edhe në procesin e marrjes në dorëzim të mallrave objekt prokurimi nga Autoriteti Kontraktor përfitues për të kryer krahasueshmërinë e specifikimeve teknike gjatë marrjes në dorëzim të tij.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje gjithashtu në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj

cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatën e origjinës së mallit objekt prokurimi.

Argumentimi: *Kërkesa për paraqitjen e certifikatës së origjinës së mallit përcaktohet me qëllim verifikimin e origjinës së konvertuesit të ofruar për garantimin e gjurmueshmërisë dhe autenticitetit të produktit.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e afatit të garancisë për artikullin objekt prokurimi konform përcaktimit të bërë në specifikimet teknike gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin e defekteve që vijnë për shkak të prodhimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se artikujt e ofruar janë cilësorë dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit të tyre.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

*Përgjegjës për hartimin e specifikimeve teknike është grupi i punës i ngritur pranë Autoritetit Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare për objektin që prokurohet, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar.***

Konvertuesi i energjisë elektrike nga bregu(bankina e ankorimit të anijes) konverton fuqinë e bregut prej 50 Hz në 60 Hz (ose anasjelltas) për të përputhur furnizimin me energji elektrike në bord të anijes. Kjo u lejon anijen të lidhet me rrjetin elektrik të portit dhe të fikë njësinë e gjenerimit të energjisë në bord gjatë qëndrimit në port, pasi anija punon me 60 Hz, ndërsa rrjeti lokal në Portin e Durrësit është 50 Hz.

Sistemi duhet të ofrojë alternativë duke lidhur energjinë e bregut me anijen, furnizimi i disponueshëm nga bregu (Porti Detar Durrës) është 380–400 V, 50 Hz, 3-fazë, ndërsa anija e Forcës Detare kërkon energji elektrike alternative 440 V - 480 V, 60 Hz, duke kërkuar domosdoshmërisht konvertim të energjisë përmes konvertuesit nga bregu(vendi i ankorimit).

Konvertuesi duhet të instalohet në një ndarje të veçantë brenda kontejnerit, duke shmangur rritjen e temperaturës brenda ndarjes së konvertuesit për shkak të shpërndarjes së nxehtësisë nga transformatori.

TË DHËNAT KRYESORE TË KONVERTUESIT

Karakteristikat kryesore	Specifikime Teknike
Treguesit e Hyrjes	
Tensioni i linjës hyrëse	3-fazë 380 V ($\pm 10\%$)
Frekuenca hyrëse	50 Hz
Treguesit e Daljes	
Tensioni i linjës dalëse	3-fazë 440–480 V
Kapaciteti i fuqisë dalëse	550-600 kVA
Frekuenca e dalëse	60 Hz

KONTEJNERI I KONVERTUESIT DUHET TË KETË NË PËRBËRJE:

- 1- Paneli kryesor hyrës 800A.
- 2- Njësia e Panelit Drive 550-600 kVA në 0.8 PF 1 Set.

- 3- Transformator Izolues me ftohje me ajër 630kVA, 380/440V.
- 4- Transformator ndihmës deri 25kVA 400/415 V (për furnizim 40A230V njëfazore).
- 5- Paneli i Ndërprerësit të daljes 1 Set.
- 6- Panel monitorimi dhe kontrolli operimi ICEM (System Integrated Control & Energy Management System) .
- 7- Sistem alarmi zjarri me një zonë.
- 8- Njësi kondicionimi.
- 9- Drita të brendshme.
- 10- Drita emergjence.
- 11- Priza 230V AC.
- 12- Buton emergjence i brendshëm dhe i jashtëm.
- 13- Drita të jashtme.
- 14- Forklift dhe pika ngritjeje për transport tokësor dhe ngritje ajrore.
- 1- Operatori ekonomik do të kryej instalimin, testimin dhe kolaudimin e Konvertuesit në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor (Porti Detar Durrës).
- 2- Garancia për një periudhë minimum 2 vjet nga data e instalimit dhe kolaudimit të mallit (Konvertuesit).
- 3- Cilësia e Konvertuesit të jetë në përputhje me kërkesat e Komunitetit Europian (CE).

Përsa i përket kërkesave të përbërësve të konvertuesit dhe konkretisht pikat 1, 2, 3 dhe 4, ato ndryshojnë në raport me kapacitetin e fuqisë dalëse të konvertuesit dhe përlogariten në mënyrë analoge (megjithëse me vlerën 50KVA këto ndryshime janë pothuajse të pallogaritëshme dhe nuk ndikojnë funksionimin e konvertitorit. Si për shëmbull kërkesa e pikës 3. "Transformator Izolues me ftohje me ajër 630 KVA, 380/440V" mund të përdoret e njëjtë për varjantet nga 550KVA deri 600KVA, pasi këta transformatorë prodhohen për grup konvertuesish nga ku kjo diferencë është normale. Të njëjtën do cilësonim edhe për pikën 4. "Transformator ndihmës deri 25KVA 400/415V (për furnizim 40A 230V njëfazore". Edhe këta transformator prodhohen me diapazone të punës për konvertues me diapazon të fuqisë, gjë e cila kuptohet qartë nga cilësimi "Transformator ndihmës DERI 25KVA..."

"ICEM" është një kërkesë funksionale e sistemit pasi plotëson të gjitha kërkesat e kontrollit dhe menaxhimit të tij sikurse nga më kryesoret:

- Driver Classification ... (Klasifikimi i Drajverëve...)
- Poëer Optimization ... (Optimizimi i Energjisë...)
- Concurrency Control ... (Kontrolli i Konkurrencës, Trajton ndarjen e burimeve eksplicite dhe implicite pa dëmtuar saktësinë e kohës...)etj...

Në rastin konkret realizimi i konvertuesit është tejet specifik dhe sigurisht që egzistojnë sisteme të tjera monitorimi, por ato veprojnë në pjesë të veçanta përbërëse të konvertuesit, apo të një natyrë tjetër të funksionimit sikurse është sistemi "Energy Systems" apo "Cluster Management" (Menaxhimi

i Njësisë): Zbatohet në kornizat inteligjente të menaxhimit të energjisë së grumbujve (ICEM) duke përdorur IA dhe tregtimin peer-to-peer....

ICEM (Integrated Control & Energy Management System) është një sistem që aplikohet kryesisht në sektorin marine, ai bashkon kontrollin e fuqisë/energjisë, propulSIONIN, generatorët, bateritë/converters dhe monitorimin në një platformë të vetme, për tju përgjigjur monitorimit të gjithë pjesëve kryesore të anijes si:

- Diesel generators
- Main engines
- Propulsion motors
- Converters/inverters
- Batteries
- PMS
- Switchboards
- Thrusters
- VFD
- PLC/automation
- Modbus TCP/RTU, CAN, Ethernet/IP etj.

Kur flitet për konceptin ICEM (Integrated Control & Energy Management System), nuk ekziston një krijues apo menaxhues i vetëm unik botëror, pasi ky është një koncept inxhinierik dhe arkitekturë teknologjike. Ai zbatohet nga kompani dhe konsorciume të ndryshme ndërkombëtare në varësi të industrisë. Pra sistemi ICEM , nuk është “prone” e një prodhuesi të caktuar dhe për pasojë ajo mund të përdoret nga të gjithë prodhuesit e të njëjtit produkt.

Për rrjedhojë, në kërkesën e mësipërme nuk synohet përcaktimi i një marke apo prodhuesi të vetëm, por kërkohet që sistemi i ofruar të realizojë funksionalisht kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike.

Në këtë kuadër, nëse një operator ekonomik ofron një sistem tjetër teknologjik, të ndryshëm në emërtim apo në prodhues, ai mund të konsiderohet ekuivalent, me kusht që operatori ekonomik të provojë në mënyrë të dokumentuar se sistemi i propozuar përmbush kërkesat funksionale dhe teknike të përcaktuara në specifikimet teknike.

Ky afat është vendosur së pari duke ju referuar testimit të tregut nga ku grupi i punës konstatoi se kjo periudhë rezulton e mjaftueshme për furnizimin/instalimin dhe testimin, po kështu edhe faktit që ky furnizim është i lidhur me realizimin e donacionit të nënshkruar midis qeverisë Shqiptare dhe asaj Italiane (të dy ministrive përkatëse të mbrojtjes) të dorëzimit të një anije luftarake të forcave detare Italiane, flotës tonë detare, anije e cila parashikohet të mbërrijë në Durrës në fillim të vitit në vijim (2027) dhe Konvertuesi në kontejner i tensionit duhet të jetë i instaluar në bankinë, ku do të ankorohet anija “Arberia”, gati për furnizimin me energjinë me parametrat përkatës të anijes.

Furnizimi me energji nga bregu i anijes do të bëhet nga Autoriteti Portual Durrës i cili kërkon kohën e nevojshme për instalimin e pikës së lidhjes për furnizim me energji nga rrjeti 3-fazor.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues kurse specifikimet teknike janë hartuar nga Autoriteti Kontraktor përfitues Komanda e Forcave Detare. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

- *Dokumentat e tenderit*
- *Specifikimet teknike*

NJËSIA E PROKURIMIT